

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës	Vendimmarrja ne biznes
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Obligative
Viti i studimeve	I
Semestri	II
Numri orëve në javë	3
Vlera në kredi - ECTS	6
Koha / lokacioni	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	Lëndë do t'u jape studentëve njohuri mbi procesin e vendimmarrjes si dhe metodat sasiore e cilësore të përdorura nga menaxheret për rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në kushte të mjediseve, të ndryshme në të cilat mund të operojë biznesi. Do të thellohen njohuritë mbi konceptin e grupeve efektive, konfliktin, personalitetin, racionalitetin e vendimeve si dhe do të bëhet një përdorim i disa teknikave sasiore të kombinuara me ato cilësore për të krijuar një kuadër sistematik ekzakt të marrjes së vendimeve
Qëllimet e lëndës	Qëllimi përfundimtar i lëndës është marrja e vendimeve menaxheriale që t'i pajisë studentët me teorinë bashkëkohore. Çdo menaxher që merr përsipër rolin e drejtdhënës të aktivitetit të organizatës, duhet të ndërmarr vendime. Menaxherët duhet të marrin vendime lidhur me organizimin, personelin dhe menaxhimin burimeve, prodhimin dhe kontrollin. Marrja e vendimeve është veçanërisht për gjitha aktivitetet planifikuese, procesin e marrjes së vendimeve si një funksion planifikues, Marrja e vendimeve në kushtet e rrezikut dhe pasigurisë, si dhe qëllimi është që merren vendime efektive si psikologjike, sociologjike të racionalitetit si dhe disa modele vendime. Qëllimi është që studentët ta njohin veten të përfshirë në gjirin e një organizate dhe vendosjen për të ardhmen e saj.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies	Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje: 1. të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për vendimmarrje të suksesshme. (ECTS-), 2. të analizojnë aspekte specifike me të cilat do të ballafaqohen gjatë zhvillimit të karrierës, (ECTS-), 3. të fitojnë shkathtësi të nevojshme në menaxhimin e vendimeve të ndryshme, (ECTS-), 4. të analizoj grupin dhe marrja e vendimeve, perspektivat e marrjes së vendimeve në grup, (ECTS-),

	5. të arrijë marrjen e vendimeve racionale. Sjellja racionale kundrejt sjelljes jo racionale dhe koncepti i maksimizimit të sjelljes. (ECTS-), 6. Të analizoj Pemën e vendimeve, informacionit shtesë në vlerësimin e dobishmërisë dhe zgjidhja e problemeve vendimmarrëse. (ECTS-),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	2	10
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kollokiume – seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies):	Ligjërata dhe procesi mësimor do të zhvillohet duke vendosur studentin në qendër të veprimtarive akademike, duke e bërë atë pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e dijes. Mësimdhënia do të organizohet përmes ligjëratave interaktive, ushtrimeve praktike dhe shembujve konkretë që lidhen drejtpërdrejt me lëndën. Studentët do të angazhohen në interpretime individuale dhe grupe, si dhe në përgatitjen e punimeve seminarike me qëllim zhvillimin e aftësive hulumtuese dhe analitike. Metodologjia do të përfshijë gjithashtu aktivitete hulumtuese të pavarura, punë të organizuara në grupe dhe prezantime para klasës, me qëllim nxitjen e aftësive komunikuese dhe bashkëpunuese. Pjesëmarrja aktive është jashtëzakonisht e rëndësishme, kështu që studentët inkurajohen që të ndjekin rregullisht leksione dhe ushtrime dhe të kontribuojnë në diskutimet që zhvillohen në leksione. Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupe, punimit të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe rasteve studimore, zgjidhjes së detyrave numerike dhe interpretimit të tyre. Në këtë mënyrë do		

	të synohet krijimi i raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.												
Metodologjia e vlerësimit dhe forma e ndërtimit të notës:	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Hartimi/prezantimi i projektit seminari...max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë: 1. Angazhimi dhe vijueshmëria në ligjërata – vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme Angazhimi në ligjërata - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në ligjërata interaktive profesor-studente, studente-studente duke hapur edhe tema të reja që janë të lidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. Vijueshmëria - nënkupton pjesëmarrjen fizike gjatë ligjëratave. 2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët e mundshme apo 20%, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shumë se 3 studente) duhet të përgatit një detyrë, projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plotë me lëndën. <table border="1" data-bbox="662 1184 1386 1430"> <tr> <th colspan="2">Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminarik</th></tr> <tr> <th>Komponenti</th><th>Pikët (%)</th></tr> <tr> <td>Struktura dhe Qëllimi i punimit</td><td>6 %</td></tr> <tr> <td>Përmbajtja/shtjellimi i punimit</td><td>8 %</td></tr> <tr> <td>Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit</td><td>6 %</td></tr> <tr> <td>Gjithsej:</td><td>20 %</td></tr> </table> Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë nga 100 pikët e mundshme, Brenda semestrit parashihet - sipas rrethanave - të mbahen dy Teste (2 x 35 + 70 pike apo 70%), testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin e parë nëse ka min 17 pike, pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë mund t'i nënshtrohet testit të dytë, studenti ka të drejtë të nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrime. Studenti do t'i	Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminarik		Komponenti	Pikët (%)	Struktura dhe Qëllimi i punimit	6 %	Përmbajtja/shtjellimi i punimit	8 %	Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	6 %	Gjithsej:	20 %
Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminarik													
Komponenti	Pikët (%)												
Struktura dhe Qëllimi i punimit	6 %												
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	8 %												
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	6 %												
Gjithsej:	20 %												

	nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies së parapare për materialin e lëndës së ligjësuar. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban: - pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, - pyetje subjektive të llojit ese/detyrë me shkrim për të cilat vetë studenti duhet të jetë në gjendje të japë përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga të gjitha kriteret e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i Smart-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, Power point, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studente, kuize studentore në klase, etj) Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në praktikë. 105 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. 45 orë janë të fokusuara në ushtrime praktike, vizita pune, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 4 ECTS (70%) i dedikohen pjesës teorike ❖ 2 ECTS (30%) i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												

Literatura	
Literatura bazë	1. Prof. Dr. Vasilika KUME, "Marrja e Vendimeve Manaxheriale" botimi i katërt, 2010 Tiranë, 2. Bazat e Vendimmarrjes në Biznes, Robbins, S. P. & Coulter, M. (2024). 3. Groebner & Shannon, "Introduction to Management Science",
Literatura shitesë	1. Luis Ángel Guerras-Martín, King Juan: : Fundamentals of Strategic Management, Carlos University, 2013, 2. Prof. Dr. Justina Pula Shiroka, "Vendimmarrje Menaxheriale", 3. Neil Ritson: Strategic Management, Ventus Publishing APS, 2011,
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Njohje me lëndën, si dhe një vështrim të përgjithshëm mbi marrjen e vendimeve Në përfundim të kësaj njësie, studenti do të ketë një njohje të përgjithshme dhe të strukturuar me lëndën "Vendimmarrja në Biznes", duke kuptuar rolin dhe rëndësinë e procesit të marrjes së vendimeve në organizata. Studenti do të njihet me konceptet bazë të vendimmarrjes, llojet kryesore të vendimeve dhe lidhjen e tyre me funksionet menaxheriale, si dhe me faktorët që ndikojnë në procesin vendimmarrës në mjedisin bashkëkohor të biznesit, duke krijuar bazën teorike për analizë dhe aplikim të mëtejshëm praktik. Rezultati i pritur nr. 1:
Java e dytë	Diagnoza e sistemeve të mendimit Sistemet organizacionale. Të menduarit në sisteme. Diagnoza. Natyra e problemeve. Analiza e sistemeve Soft. Analiza e sistemeve Hard Studenti do të zhvillojë aftësi për të kuptuar dhe analizuar sistemet e mendimit dhe sistemet organizacionale, duke aplikuar qasjen e të menduarit në sisteme në identifikimin dhe diagnostikimin e problemeve të biznesit. Studenti do të jetë në gjendje të dallojë natyrën e problemeve organizative, të kryejë diagnozë të situatave komplekse, si dhe të kuptojë dhe aplikojë parimet bazë të analizës së sistemeve, duke diferencuar ndërmjet analizës së sistemeve Soft dhe Hard, si bazë për marrjen e vendimeve më të informuara dhe efektive në organizata. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e tretë	Procesi i marrjes së vendimeve. Funksionet e procesit të marrjes së vendimeve. Marrja e vendimeve, një proces i nderlidhur. Marrja e vendimeve, një proces dinamik. Studenti do të kuptojë procesin e marrjes së vendimeve si një proces të strukturuar, të nderlidhur dhe dinamik, duke njohur funksionet kryesore të tij nga identifikimi i problemit, mbledhja dhe analiza e informacionit, formulimi i alternativave, zgjedhja e vendimit deri te zbatimi dhe vlerësimi i tij. Studenti do të jetë në gjendje të analizojë mënyrën se si këto funksione ndërveprojnë dhe ndikojnë njëra-tjetrën në kushte të ndryshimit dhe pasigurive, si dhe të kuptojë natyrën dinamike të vendimmarrjes në mjedisin bashkëkohor të

	biznesit, duke zhvilluar aftësi për të marrë vendime më efektive dhe të qëndrueshme. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
Java e katërt	Funksionet e procesit të marrjes se vendimeve. Marrja e vendimeve, një proces i ndërlidhur. Marrja e vendimeve, një proces dinamik. Modelet për marrjen e vendimeve Rezultati i pritur nr. 1, 2 dhe 3.
Java e pestë	Grupi dhe marrja e vendimeve Perspektivat e marrjes se vendimeve ne grup Rezultati i pritur nr. 1, 2 dhe 3.
Java e gjashtë	Kontesti organizativ i marrjes se vendimeve Rast studimi Kompania "Kingston" Rezultati i pritur nr. 1, 2 dhe 3.
Java e shtatë	Kollokiumi 1 - Vlerësimi i parë intermedier Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e tetë	Psikologjia e marrjes se vendimeve Personaliteti ne marrjen e vendimeve. Gjykimi në kushte pasigurie. Prirja për te ndermarrë risk. Precept imi ne marrjen e vendimeve. Vlerat për marrjen e vendimit Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e nëntë	Marrja e vendimeve racionale Sjellja racionale kundrejt sjelljes jo racionale. Koncepti i maksimizimit të sjelljes. Koncepti i kënaqësisë së sjelljes. Racionali teti i kufizuar. Gracka, shkallëzimi ne marrjen e një vendimi. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e dhjetë	A jeni një marrës i mirë, i vendimeve? Kushtet e marrjes se vendimeve Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e njëmbëdhjetë	Marrja e vendimeve në kushte risku\Teoria e lojes. Pema e vendimit dhe vlere e informacionit. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e dymbëdhjetë	Pema e vendimeve. Përfshirja e informacionit shtesë në pemën e vendimit. Vlerësimi i dobishmërisë. Ushtrime dhe problem Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 4.
Java e trembëdhjetë	Marrja e vendimeve dhe menaxhimi. Marrësi i vendimeve. Ushtrime dhe probleme Airbus kundrejt Boeing

Java e katërbëdhjetë	Teknikat e marrjes se vendimeve
Java e pesëmbëdhjetë	Kollokiumi II - Vlerësimi i dytë intermedier
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Një nga shenjat se materiali i lëndës është kuptuar siç duhet është ndershmëria gjatë kryerjes së detyrave. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, ligjëruesi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	